



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1126/5 Prot.

Tiranë, më 14. 08.2025

V E N D I M

Nr. 201, datë 14. 08. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 169 Regj., datë 28.07.2025, të shtetasit A. T., kundër Kontrollit të Lartë të Shtetit, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, ndër të tjera, shprehet se: “Z. Komisioner; Duke shprehur konsideratë për veprimtarinë dhe misionin e institucionit që Ju përfaqësoni, lutem më lejoni të paraqes ankesën time, si dhe argumentet mbështetëse, në lidhje me pretendimet e mia për të kërkuar konstatimin nga ana Juaj të diskriminimit që më është shkaktuar gjatë marrëdhënies së punës si nëpunës civil pranë KLSH, për periudhën 03.07.2020 deri 14.02.2025, nga ana e zyrtarit autorizues A. Sh. në pozicionin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Unë, ankuesi A. T., jam në cilësinë e ish-nëpunësit civil në pozicionin Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të Performancës, në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Për shkak të nisjes së një hetimi administrativ ndaj meje si nëpunës civil, me vendimin nr. 83/19 Prot., datë 27.02.2025, Komisioni Disiplinor i Kontrollit të Lartë të Shtetit më ka dhënë masën disiplinore të largimit nga shërbimi civil.

Jam punësuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit në muajin nëntor 2014. Që prej atij viti dhe deri në datën 14.02.2025, datë në të cilën është marrë vendimi nga Kryetari i Kontrollit të

¹ Pa provuar apo dokumentuar se çfarë pretendon a shpjegon ankuesi me këtë shkak.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Lartë të Shtetit për largimin tim nga Shërbimi Civil, kam qenë pjesë e stafit të KLSH-së pa asnjë vërejtje apo shkelje të dokumentuar pranë këtij institucioni.

Lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën 01.01.2024 deri 31.12.2024

Më datë 10.01.2025 (e premte), jam vënë në dijeni nga zyrtarët raportues A. Z. dhe A. G. për vlerësimin e 6-mujorit të dytë të vitit 2024. Duke qenë se vlerësimi i përgjithshëm dhe vlerësimi i gjithë elementëve/indikatoreve të vlerësuar nga zyrtari raportues/eprori direkt ishte pozitiv me notën 2 (dy) mirë, kam kundërshtuar vlerësimin e zyrtarit autorizues A. Sh./Kryetar i KLSH-së, atë me notën 4 (katër) jo kënaqshëm, duke u shprehur në formularin e vlerësimit që "Nuk jam dakord", si dhe kam kërkuar rivlerësim duke cilësuar gjithashtu me shkrim dore mbi formularin e vlerësimit se "Do të paraqes kundërshtimet e mia me shkrim tek Kryetari i KLSH-së", në cilësinë e Zyrtarit Autorizues.

Më datë 14.01.2025 (e martë) nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në KLSH, jam njohur me rivlerësimin e bërë nga ana e Zyrtarit Autorizues, i cili është shprehur: "Konfirmoj vlerësimin e dhënë", pa bërë asnjë koment, pa dhënë asnjë argument apo fakt për arsyet e vlerësimit negativ në punë. Konstatohet se rivlerësimi është bërë në datën 13.01.2025 (e Hënë), sipas shënimeve të Zyrtarit Autorizues. Pra, Zyrtari Autorizues nuk ka shqyrtuar fare kundërshtimet e mia, duke rikonfirmuar vlerësimin e tij përpara afateve ligjore.

2. Lidhur me veprimtarinë time përgjatë vitit 2024 si nëpunës pranë KLSH

Nga data 01.01.2024 deri në datën 19.01.2024, kam qenë i angazhuar si Auditues i Lartë tek Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, për kryerjen e auditimit në Autoritetin Portual Durrës, sipas Programit të Auditimit me nr. 631/2 prot., datë 26.07.2023, i ndryshuar, me angazhim në terren nga ana ime deri në datën 19.01.2024, vërtetuar kjo edhe me aktet përkatëse të konstatimit të protokolluara pranë APD-së. Konkretisht, unë si auditues, kam mbajtur aktet e konstatimit me nr. 7, nr. 9, nr. 10, nr. 12 dhe nr. 25, datë 19.01.2024, protokolli i Autoritetit Portual Durrës.

Me shkresën nr. 225 Prot., datë 08.02.2024, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nxjerr një Autorizim, ku përcakton se: "Z. A. T., me detyrë "Auditues i Lartë" në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, të ushtrojë detyrat e "Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse", sipas përcaktimeve të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së, deri në përfundim të procedurave për plotësimin e pozicionit të Drejtorit të Drejtorisë"...

Me shkresën nr. 318/5 Prot., datë 02.04.2024, Kryetari i KLSH-së nxjerr vendimin nr. 55, datë 02.04.2024, me anë të të cilit vendos: "Për fillimin e marrëdhënieve të punës dhe financiare për z. A. T., në pozicionin 'Drejtore të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse'". Në datën 08.05.2024, tek faqja zyrtare e institucionit, seksioni CV, është publikuar dhe një CV e përmbledhur për mua, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të institucionit.

Në vazhdim, me shkresën nr. 818/4 Prot., datë 30.07.2024, Kryetari i KLSH-së nxjerr vendimin për Ndryshim Kategorie dhe Departamenti për z. A. T. Tek pika 1 e vendimit cilësohet: "Z. A. T., aktualisht në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, kalon në pozicionin e Audituesit të Lartë, në Departamentin e Auditimit të Performancës, Sektori i Auditimit të Performancës." Vendimi hyn në fuqi në datën 01.08.2024.

Gjithashtu, ju bëj me dije se vlerësimi i përgjithshëm në 6-mujorin e mëparshëm për periudhën 01.01.2024 deri më 02.04.2024, datë në të cilën u emërova Drejtor Drejtorie, ka qenë 1 (shumë mirë), në pozicionin e Audituesit të Lartë tek Departamenti i Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja. Ndërsa për periudhën e mbetur të 6-mujorit të parë, nga 02.04.2024 deri më 31.07.2024, vlerësimi ka qenë 2 (dy) nga Zyrtari Raportues dhe 3 (tre) nga Zyrtari Autorizues/Kryetari i KLSH-së.

Në vazhdim, nga data 01.08.2024 deri në datën 31.12.2024, kam qenë me pozicion Auditues i Lartë tek Departamenti i Auditimit të Performancës në Institucion. Gjatë kësaj periudhe kam qenë anëtar i një programi auditimi tek Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, por u angazhova vetëm 2 javë, pasi përsëri, në mënyrë arbitrare dhe pa asnjë shpjegim, u urdhërova verbalisht nga zyrtari raportues që të stacionohesha në zyrë në KLSH.

Gjithashtu, kam qenë pjesë e një programi auditimi për zbatim rekomandimesh në muajin dhjetor 2024, por në këtë auditim jam paraqitur në muajin janar, pasi isha me leje në muajin dhjetor 2024.

Si rezultat, i nderuar Komisioner, për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024, pra nga data 01.08.2024 deri në datën 31.12.2024, nuk jam angazhuar në procese auditimi dhe as nuk më është ngarkuar ndonjë detyrë për ta kryer, edhe pse unë personalisht, me e-mailin e datës 24.10.2024 (bashkëlidhur), kam njoftuar eprorin direkt se jam pa angazhim.

Konkretisht, në këtë e-mail me subjekt "Informacion ditor. Data 24.10.2024", kam cilësuar midis të tjerash se: "Sot, datë 24.10.2024, jam në KLSH dhe nuk jam i angazhuar në asnjë auditim të Departamentit të Performancës."

Në këto kushte, është absurde dhe e papranueshme që të vlerësohem me 4 (katër) nga Zyrtari Autorizues, për një punë që nuk e kam kryer ose për detyra që nuk më janë ngarkuar kurrë. Ky vlerësim absurd, nuk mund të përfaqësojë kurrë punën apo profesionalizmin tim si nëpunës civil..

Ndodhem para një paradoksi ekstrem, ku nuk më është dhënë asnjë sqarim nga Zyrtari Autorizues, për arsyet pse jam vlerësuar "jo kënaqshëm", ndërkohë që nuk jam ngarkuar me asnjë detyrë.

3. Lidhur me disa fakte gjatë punës sime në KLSH për periudhën 03.07.2020 deri më 31.12.2024:

Nga data 14.12.2020, sipas Urdhrit nr. 125 Prot., datë 14.12.2020, të Kryetarit aktual të KLSH-së, kam ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit.

Në vazhdim, me Urdhrin nr. 19, datë 12.02.2021 dhe nr. 255 Prot., datë 12.02.2021, Kryetari aktual i KLSH-së urdhëron, sipas pikës 1 të këtij urdhri, si më poshtë: “Z. Gj. P, Drejtor i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, të ushtrojë kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm, të nëpunësit Autorizues dhe Zyrtarit Autorizues, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, deri në përfundim të procedurave të emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm.” Tek pika 2 e të njëjtit urdhër, përcaktohet: “Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet z. Gj. P., Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Financës.”

Në vijim të punës sime në KLSH, pas mbarimit të periudhës si Sekretar i Përgjithshëm, kam vijuar detyrën në pozicione të tjera si Auditues i Lartë dhe më pas, siç kam përmendur më herët, u emërova Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe më pas, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

Pavarësisht lëvizjeve në pozicione të ndryshme, gjatë gjithë periudhës 2020–2024, jam përpjekur të ushtroj detyrën me përkushtim dhe profesionalizëm, duke respektuar kuadrin ligjor e etikën e nëpunësit civil, pavarësisht ndryshimeve të shpeshta në strukturë dhe organizim brenda institucionit.

Është me rëndësi të theksohet se asnjëherë gjatë kësaj periudhe nuk kam pasur masë disiplinore dhe gjithashtu nuk jam përfshirë në asnjë hetim administrativ për çështje etike apo profesionale. E gjithë veprimtaria ime ka qenë transparente dhe e dokumentuar përmes akteve të auditimit, raporteve të punës dhe komunikimeve zyrtare me eprorët dhe Burimet Njerëzore.

Në këtë kontekst, vlerësimi i dhënë për mua me notën “4 - Jo kënaqshëm”, për periudhën gjashtëmujore Korrik-Dhjetor 2024, nuk pasqyron aspak realitetin e veprimtarisë sime gjatë asaj periudhe, për më tepër kur nuk ka pasur angazhim të qartë, detyra specifike të ngarkuara, apo ndonjë dokument që të konstatojë mangësi në performancë.

Pas fillimit të detyrës së Sekretarit të ri të Institucionit, z. Gj. P, pra pas datës 12.02.2021, kam qenë në pritje të marrjes së ndonjë detyre audituese. Në vazhdim, sa më kujtohet, deri në fund të vitit 2023, jam caktuar në auditimet e radhës si tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Tropojë, Bashkia Bulqizë, Bashkia Vau — Dejës, AKBN/MIE, Porti Detar Sarandë, Hekurudha Shqiptare, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Ujësjellës Kanalizime Shkodër, Bashkia Selenicë dhe Autoriteti Portual Durrës. Auditimi i këtij të fundit ka përfunduar në terren në datën 19.01.2024, duke u dorëzuar aktet e konstatimit nga grupi i auditimit, dhe është hartuar edhe Projekt-Raporti i Auditimit, por deri në këto momente, nuk jam në dijeni nga përgjegjësi i grupit ose eprori direkt për

vazhdimin e proceseve për përmbylljen dhe evadimin e dosjes së auditimit të kryer tek Autoriteti Portual Durrës.

Njëkohësisht, gjatë periudhës shtator 2021 deri tetor 2021, jam autorizuar nga Kryetari aktual i KLSH-së për të kryer detyrat e Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse të Institucionit, sipas shkresës me nr. 834 prot., datë 28.09.2021. Këtë detyrë e kam mbajtur deri në datën 11.10.2021, datë në të cilën është emëruar në detyrë z. Ardian Myslimaj në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse të KLSH.

Me shkresën nr. 225 prot., datë 08.02.2024, Kryetari i KLSH-së nxjerr Autorizimin, me të cilin, sipas pikës (1) të tij, midis të tjerash cilëson: “Z. A.T., me detyrë ‘Auditues i Lartë’ në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, të ushtrojë detyrat e ‘Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse’, sipas përcaktimeve të Rregullores...”. Në këtë pozicion, si Drejtor i autorizuar, kam vazhduar deri në datën 02.04.2024, datë në të cilën Kryetari i KLSH, nxjerr Vendimin nr. 55, sipas shkresës me nr. 318/5 Prot., datë 02.04.2024, me anë të të cilit, midis të tjerash, vendos: “Fillimin e marrëdhënieve të punës dhe financiare për z. A. T., në pozicionin ‘Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse’, më datë 04.04.2024”. Ky pozicion është fituar nga ana ime nëpërmjet një konkurimi brenda kornizave ligjore, sipas dhe njoftimit për web të publikuar në faqen zyrtare të KLSH-së në datën 28.02.2024, “Shpallje për nëpunës civil, Ngritje në detyrë, konkurim i brendshëm”, ku tek seksioni II, “Kushtet që duhet të plotësojë kandidati dhe kriteret e veçanta”, midis të tjerash cilësohet se: Të jetë diplomuar jo më poshtë se niveli Master Shkencor në Shkenca Juridike / Shkenca Ekonomike / Shkenca Inxhinierike; të ketë përvojë pune në fushën profesionale minimumi 10 vjet, nga të cilat minimumi 3 vjet në KLSH...

Këto kriteret që kanë qenë vendosur në atë kohë (viti 2024), për të cilat unë u shpalla fitues i pozicionit Drejtor Drejtorie, këtë vit, në datën 31.01.2025, sipas njoftimit në faqen web të KLSH-së, kriteret e kualifikimit nuk janë të njëjta, pasi nuk kërkohet që kandidati të jetë diplomuar jo më poshtë se Master Shkencor në Shkenca Inxhinierike, por vetëm në Shkencat Juridike ose Ekonomike.

Duhet theksuar gjithashtu se në muajin janar 2025 kanë nisur auditime të reja dhe vihet re se, në rolin e përgjegjësit të grupit, ka auditues që janë vlerësuar me notën 4 (katër) “jo kënaqshëm” për 6-mujorin e dytë të vitit 2024. Konkretisht, sipas Programit të Auditimit Tematik me nr. 131/1 Prot., datë 20.01.2025 “Mbi Auditimin e Përputhshmërisë”, me objekt “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKBN, mbi monitorimin e HEC ‘Sasaj’ Sarandë”, me periudhë auditimi nga fillimi i koncesionit deri më datë 31.01.2025 dhe me afat auditimi nga data 21.01.2025 deri në datën 21.02.2025, grupi i auditimit, në përbërje të tij, ka edhe z. Artan Topjana në rolin e përgjegjësit të grupit të auditimit, i cili është vlerësuar me notën 4 (“jo kënaqshëm”) nga Kryetari i KLSH-së për periudhën 01.08.2024 deri 31.12.2024.

Në vazhdim, z. K. Gj., auditues i KLSH-së, i vlerësuar po me notën 4 (“jo kënaqshëm”), është anëtar i grupit të auditimit sipas Programit të Auditimit me nr. 631/9 Prot., datë 20.01.2025 për “Auditimin e Përputhshmërisë mbi Veprimtarinë e Autoritetit Portual Durrës”. I njëjti

auditues, pra z. Gj., i vlerësuar me notën 4 (“jo kënaqshëm”), është edhe Përgjegjës i Grupit të Auditimit mbi “Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë” në Bashkinë Vlorë për periudhën në auditim prej datës 01.01.2023 – 31.12.2023 dhe afat auditimi nga data 24.01.2025 deri në datën 04.04.2025, sipas Programit të Auditimeve të miratuar sipas vendimit të Kryetarit të KLSH-së me shkresën nr. 98/1 Prot., datë 11.02.2025.

Në vazhdim, audituesi z. B. M., i vlerësuar nga Kryetari i KLSH-së me notën 4 (“jo kënaqshëm”), është caktuar në pozicionin e përgjegjës të grupit të auditimit mbi “Auditimin e Përputhshmërisë”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri 31.12.2024 tek Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, me afat auditimi nga data 27.01.2025 deri në datën 14.03.2025, sipas Programit të Auditimeve të miratuar sipas vendimit të Kryetarit të KLSH-së me shkresën nr. 98/1 Prot., datë 11.02.2025.

Në vazhdim, audituesi z. P. Gj., i vlerësuar nga Kryetari i KLSH-së me notën 4 (“jo kënaqshëm”), është caktuar në pozicionin e përgjegjës të grupit të auditimit mbi “Auditimin Financiar”, për periudhën nga data 01.01.2023 deri 31.12.2023 tek Bashkia Dibër, me afat auditimi nga data 24.01.2025 deri në datën 04.04.2025. Injēti auditues është edhe tek auditimi “Auditim Performance” me temë: “Ndikimi në mjedis dhe shëndet i aktivitetit të shfrytëzimit të naftës dhe gazit në zonën Patos-Marinëz”, si anëtar grupi auditimi, me afat auditimi nga data 17.01.2025 deri në datën 25.04.2025, sipas Programit të Auditimeve të miratuar sipas vendimit të Kryetarit të KLSH-së me shkresën nr. 98 Prot., datë 15.01.2025 dhe nr. 98/1 Prot., datë 11.02.2025.

Gjithashtu, nga periudha 01.08.2024 deri në datën 31.12.2024, periudhë në të cilën jam vlerësuar me notën 4 (“jo kënaqshëm”) nga Kryetari i KLSH-së, unë nuk kam qenë i angazhuar në asnjë auditim, dhe këtu nënkuptoj që nuk kam përmbyllur asnjë auditim, edhe pse isha caktuar në vetëm dy programe auditimi. Asnjë nga këto nuk i kam përmbyllur, pasi në njërën auditim isha vetëm 2 javë (pasi më tërhoqën në mënyrë verbale) dhe në tjetrin isha vetëm 1 javë në muajin dhjetor 2024, pasi përmbyllja u bë në muajin janar 2025. Nga Departamenti i Performancës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, kam qenë i vetmi punonjës pa asnjë auditim për afro 6 muaj. Praktikisht, nga Departamenti i Performancës ku kam qenë i emëruar në datën 01.08.2024, nuk kam pasur asnjë aktivitet, punë apo angazhim me rezultate, mbi të cilat do të mund të bëhej vlerësimi i performancës së punës sime për 6-mujorin e dytë të vitit 2024.

Së fundmi, pas vënies në dijeni të një vlerësimi negativ ndaj meje pa asnjë arsye dhe shpjegim nga eprori direkt apo edhe Titullari i Institucionit, kam reaguar ndoshta me tone dhe fjalë jo të pëlqyeshme me një mik dhe që ishte njëherësh koleg pune. Pavarësisht se korrespondenca me këtë person është bërë jashtë orarit zyrtar dhe në formën e një reagimi njerëzor tek një person me të cilin kisha marrëdhënie shoqërore, ky i fundit ka bërë publike dhe i ka dhënë karakter formal kësaj korrespondence.

Kjo korrespondencë ndërpersonale, e zbardhur dhe vënë në dukje nga një koleg pune tek kryetari i KLSH-së, pa asnjë dëshirë, vullnet apo kërkesë timen, ky i fundit në vazhdim me urdhrin nr. 07, datë 20.01.2025, ka ngritur Komisionin Disiplinor për shqyrtimin e kërkesës

për fillimin e procedimit disiplinor. Në vazhdim, Komisioni Disiplinor ka mbajtur shkresën nr. 83/ll Prot., datë 24.01.2025, me lëndë: "Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore" të filluar ndaj meje për mesazhet e dërguara kryesisht tek "miku" im. Pasi nga Komisioni Disiplinor sms e dërguar nga unë është klasifikuar si shkelje e rëndë, në kundërshtim me sa parashtron ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", pika 2 dhe 3 e nenit 57, kam paraqitur kundërshtimet e mia me shkrim për ngritjen e këtij komisioni, të cilat i gjeni bashkëlidhur kësaj ankese. Duke zhvlerësuar në analizë qëndrimin tim, Komisioni Disiplinor ka dalë në datën 07.02.2025, sipas shkresës me nr. 83/19 Prot., me vendimin përfundimtar "Për largim nga Shërbimi Civil", duke klasifikuar korrespondencën time ndërpersonale jashtë orarit zyrtar me një koleg në marrëdhënie shoqërore si shkelje shumë të rëndë disiplinore!

b) Lidhur me mungesën e koherencës në angazhimin, zënien me punë dhe stabilitetin në rolet dhe detyrat e mbuluara:

Në rrjedhojë të ndryshimeve të pozicioneve të punës disa herë brenda pak muajsh gjatë vitit 2024, siç është sqaruar më sipër, me shkresën nr. 818/1 Prot., datë 30.07.2024, Kryetari i KLSH-së ka nxjerrë vendimin nr. 145, datë 30.07.2024 për "Disa ndryshime në vendimin nr. 19, datë 31.01.2022, mbi miratimin e strukturës organizative të Kontrollit të Lartë të Shtetit, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave të ndryshuar". Në vijim, me shkresën nr. 818/4 Prot., datë 30.07.2024, Kryetari i KLSH-së ka nxjerrë vendimin për ndryshim Kategorisë dhe Departamentit për z. A. T., ku nga pozicioni i Drejtorit në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, kaloj në pozicionin e Audituesit të Lartë, në Departamentin e Auditimit të Performancës, Sektori i Auditimit të Performancës, me hyrje në fuqi nga data 01.08.2024.

Kjo paqëndrueshmëri në përcaktimin e detyrave që do të mbuloja në harkun kohor të pak muajve, ka sjellë që Kryetari i KLSH-së të ndryshojë kategorinë dhe klasën e pagës në mënyrë arbitrare, nga Kategoria I, Klasa e pagës 1-4 — Drejtor Drejtorie, në Kategorinë II, Klasa e pagës 11-2 — Auditues i Lartë, në kundërshtim flagrant me: 1. Pikën 1, të nenit 37 "Statusi i punonjësve dhe rregullat etike", të Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku përcaktohet se: "Administrimi i shërbimit civil në Kontrollin e Lartë të Shtetit, rekrutimi, ngritja në detyrë, lëvizja paralele, vlerësimi, transferimi, lirimi, pezullimi, si dhe masat e tjera disiplinore për punonjësit e këtij institucioni bëhen në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil"; 2. Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", me ndryshime, duke nxjerrë një urdhër dhe pa ndjekur asnjë procedurë ligjore, por edhe VKM nr. 125, datë 17.02.2016 "Për Transferimin e Përkohshëm dhe të Përhershëm të Nëpunësve Civilë", Kreu IV, "Transferimi i Përhershëm për Shkak të Shmangies së Konfliktit të Vazhdueshëm të Interesit".

Paqëndrueshmëria në përcaktimin e detyrave, pa arsyetim për shkakun objektiv që do të përlligjte veprimin në funksion të interesit publik që duhet të mbrojë veprimtaria e KLSH-së, duke sjellë njëherësh edhe ulje në gradë të statusit të nëpunësit civil, në shkelje të procedurave ligjore dhe mungesës së një trajtimi të tillë për punonjësit e tjerë të KLSH-së, përbën një diferencim që shkakton ndjenjën e pasigurisë në marrëdhënien e punës dhe ushtrimin e detyrës publike, si dhe dallim negativ në krahasim me punonjësit e tjerë të të njëjtit nivel.

c) Mungesa e argumentimit minimal në ndryshimin e vlerësimit të përgjithshëm 6-mujor për periudhën 01.01.2024 – 02.04.2024:

Në periudhën 01.01.2024 deri më 02.04.2024, ku kam qenë Drejtor Drejtorie, vlerësimi im ishte 1 (shumë mirë). Në periudhën tjetër, 02.04.2024 deri më 31.07.2024, si Auditues i Lartë në Departamentin e Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, vlerësimi ka rezultuar 2 (dy) nga Zyrtari Raportues dhe 3 (tre) nga Zyrtari Autorizues/Kryetari i KLSH-së, duke qenë pa argumente apo lidhje me performancën time si Drejtor Drejtorie. Nuk kam marrë asnjë vërejtje me shkrim nga asnjëra palë. Gjatë gjithë vitit 2024, nuk jam vënë në dijeni për ndonjë dokument që pasqyrojë shkelje apo vërejtje ndaj meje. Në këtë vlerësim, Zyrtari Autorizues ka sigluar seksionin "Nuk jam dakord me vlerësimin e Zyrtarit Raportues", por ka shënuar me shkrim dore "E vlerësoj kënaqshëm me 4".

Nga data 01.08.2024 deri më 31.12.2024, në pozicion Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të Performancës, pasiguria në vijueshmërinë e marrëdhënies së punës ishte e shtuar pa arsye. Gjatë kësaj periudhe kam qenë pjesë e programit të auditimit në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura vetëm për 2 javë, pasi më është urdhëruar verbalisht nga Zyrtari Raportues të stacionohesha në zyrën e KLSH-së. Kam qenë gjithashtu pjesë e një programi auditimi për zbatim rekomandimesh në dhjetor 2024, por jam paraqitur vetëm në janar 2025, pasi isha me leje në dhjetor. Për shkak të mungesës së angazhimit në auditime për 6 muaj, me emailin e datës 24.10.2024 kam njoftuar eprorin direkt për këtë gjendje (bashkëngjitur).

Megjithatë, pavarësisht trajtimit diferencues dhe mungesës së punës, kam marrë vlerësimin 4 (katër) nga Zyrtari Autorizues për një punë që nuk kam kryer, në një veprim arbitrar dhe pa asnjë shpjegim. Ky vlerësim nuk pasqyron punën dhe profesionalizmin tim si nëpunës civil.

Kjo situatë tregon një trajtim diskriminues ndaj meje, duke më kufizuar padrejtësisht në të drejtën për të treguar aftësitë e mia dhe duke më vendosur në kushte të pabarabarta me kolegët e tjerë, dhe gjithashtu më ekspozon para një perspektive negative në karrierë, pa asnjë shkak lidhur me sjelljen apo punën time.

d) Lidhur me ri-auditimet e urdhëruara nga Kryetari i KLSH mbi auditimet e kryera veçanërisht nga ana ime:

Referuar ri-auditimeve të urdhëruara nga Kryetari i KLSH, në periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2023, në programin e auditimit të përputhshmërisë nr. 631/2 Prot., datë 26.07.2023, të ushtruara në Autoritetin Portual Durrës, dhe duke pasur parasysh luhatjen në përcaktimin e rolit dhe funksioneve që duhej të kryeja, Kryetari i KLSH-së ka vënë në pikëpyetje veprimtarinë dhe profesionalizmin tim pa bazë faktike, duke cenuar dinjitetin dhe moralin e detyrës, pa dhënë asnjë shpjegim lidhur me aftësitë, etikën apo disiplinën time.

e) Trajtim i ndryshëm në angazhimin me veprimtari audituese, në kushte të ngjashme vlerësimi profesional:

Shumë kolegë të cilët janë vlerësuar jo kënaqshëm nga Kryetari i KLSH, sikurse unë, janë angazhuar në veprimtari audituese, ndryshe nga unë. Në periudhën 01.08.2024 deri më 31.12.2024, gjatë së cilës kam marrë notën 4 (jo kënaqshëm), unë nuk kam qenë i angazhuar në asnjë auditim të përmbyllur. Kam qenë caktuar në dy programe auditimi, por nuk kam përfunduar asnjërin, pasi në njërin kam qenë vetëm 2 javë para se të tërhiqesha verbalisht dhe në tjetrin kam qenë vetëm një javë në dhjetor 2024, ndërsa përmbyllja ka ndodhur në janar 2025.

Komisioneri duhet të marrë në konsideratë se, nga Departamenti i Performancës së KLSH-së, kam qenë i vetmi punonjës pa asnjë auditim për afro 6 muaj, ndërkohë që punonjës të tjerë të sektorit kanë qenë të angazhuar në auditime, duke më pamundësuar në mënyrë të padrejtë të konkurroj në performancë pune krahasuar me ta. Nevoja për barazi në performancë dhe promovim natyral kërkon mundësi të barabarta për të demonstruar aftësitë profesionale në punë të ngjashme në natyrë, cilësi dhe vëllim.

Konkluzion

Bazuar në nenin 32/1/a të Ligjit, Ju keni kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që lidhen me zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, përveç rasteve të përmendura në mënyrë të qartë në ligj. Veprimet e KLSH-së në trajtimin tim si nëpunës civil në këtë institucion kanë qenë të kundërligjshme dhe kanë krijuar një situatë diskriminuese, duke më ekspozuar ndaj trajtimit të pabarabartë në krahasim me punonjësit e tjerë të KLSH-së. Mungesa e arsytimit minimal për vendimmarrjet e KLSH-së, si punëdhënëse, ka krijuar kushte të pafavorshme dhe të dallueshme për mua, duke më vendosur në një pozitë të padrejtë në marrëdhënien e punës.

Kjo gjendje ka ndikuar negativisht në karrierën time si nëpunës civil, duke shkaktuar dëmtim dhe ndërprerje të zhvillimit tim profesional për shkak të marrëdhënies së tensionuar njerëzore me titullarin e KLSH-së, i cili ka ushtruar sjellje diskriminuese ndaj meje. Sjellja e diferencuar dhe paragjyquese, e zgjatur për më shumë se një vit, ka stigmatizuar punën time të viteve të kaluara, duke më ekspozuar ndaj pasoja të rënda, përfshirë largimin nga shërbimi publik pas afro 12 vitesh pune të dalluar dhe pa rekorde disiplinore.

Në përputhje me nenin 12, pika 1 të Ligjit për Ndalimin e Diskriminimit, "Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim", duke përfshirë trajtimin në vendin e punës, ndryshimin e kushteve të punës, shpërblimin dhe mundësitë e avancimit profesional. Kjo është shkelur në rastin tim.

Gjithashtu, vlen të theksohet se ekzistojnë më shumë se dy raste të punonjësve me vlerësime negative (nota 4 - jo kënaqshëm), ku trajtimi ka qenë i ndryshëm: disa janë angazhuar në auditime, ndërsa unë jam lënë jashtë çdo angazhimi për afro 6 muaj, pavarësisht kualifikimeve dhe kritereve të ngjashme profesionale. Kjo pasqyron një pabarazi të qartë në trajtim dhe në mundësitë për të zhvilluar karrierën brenda institucionit.

Përpjekjet e KLSH-së për të më ngritur dhe më pas shkarkuar nga pozicioni im janë bërë në mungesë të një trajtimi të barabartë me kolegët e tjerë, pa asnjë arsyetim të bazuar në performancë reale apo kriteret objektive. Mungesa e arsytimit dhe vendosja pa kriter e vlerësimeve negative në gjysmën e dytë të vitit 2024, bashkë me mosangazhimin tim në auditime për periudhën përkatëse, dëshmojnë një diskriminim të qartë në marrëdhënien e punës.

Vlerësoj se Kryetari aktual i KLSH-së ka përdorur pozitën e tij për të më marginalizuar në institucion, bazuar në preferenca subjektive dhe marrëdhënie personale, duke tentuar të më largojë në mënyrë të padrejtë dhe të paarsyeshme nga shërbimi publik.

Për të gjitha këto arsye, kërkoj nga Komisioneri që të konstatojë shkeljen e parimit të barazisë dhe diskriminimin në trajtimin tim si nëpunës civil pranë KLSH-së, si dhe të ndërmarrë masat ligjore për rikthimin e barazisë dhe drejtësisë në marrëdhënien e punës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së tij, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri:

1. Konstatimin e diskriminimit në marrëdhënien e punës të kryer nga punëmarrë Kontrolli i Lartë i Shtetit.
2. Marrjen e masave administrative ndaj Kontrollit të Lartë të Shtetit që ka shkelur të drejtën për të mos u diskriminuar në marrëdhënien e punës.
3. Njoftimin e subjektit/kërkues për rezultatet e hetimit administrativ.

Pas pranimit të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me dokumentacionin provues lidhur me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues.

- Për këtë arsye, nëpërmjet shkresës me nr. 1126/2 prot., datë 29.07.2025, nga ana e KMD-së, është proceduar me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit e informacionit të nevojshëm duke qartësuar e provuar shkakun për të cilin pretendohet diskriminimi, për vijimin e shqyrtimit të ankesës së tij.
- Me shkresën nr. 1126/3 prot., datë 04.08.2025 është administruar pranë Komisionerit, përgjigja e kthyer nga subjekti ankues, i cili ka sqaruar si shkak “çdo shkak tjetër”, “Për shkak të raportit personal të ftohtë, me titullarin e institucionit”, të pashoqëruar me ndonjë shpjegim të qartë të marrëdhënieve të tyre, provë a fakt konkret lidhur me marrëdhëniet me punëmarrësin.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Referuar ankesës rezulton se, z. A. T., ka ushtruar detyrën e tij si nëpunës civil pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit që prej muajit nëntor të vitit 2014, duke u emëruar fillimisht në pozicionin e audituesit. Gjatë periudhës 2015–2020, ai ka qenë i angazhuar në auditime të ndryshme të zhvilluara në institucione publike në fushën e shëndetësisë, pushtetit vendor dhe sektorë të tjerë të administratës, ku ka fituar përvojë të konsiderueshme në fushën e auditimit të jashtëm publik.

Në bazë të Urdhrit nr. 125 Prot., datë 14.12.2020 të Kryetari të KLSH-së ankuesi ka ushtruar për një periudhë dhe kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm të KLSH-së.

Nga data 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2023, z. T., ka qenë anëtar i grupeve të auditimit të përputhshmërisë dhe të performancës në auditime të ushtruara në institucione të rëndësishme si Autoriteti Portual Durrës, Spitali Memorial Fier, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, etj., duke dhënë kontribut të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm në përmbushjen e objektivave të auditimit institucional.

Në fillim të vitit 2024, konkretisht nga data 1 janar deri më 2 prill, ai ka ushtruar funksionin si auditues pranë Departamentit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja. Më datë 2 prill 2024, ai është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, përmes një vendimi të Kryetarit të KLSH-së.

Vetëm pak muaj më vonë, më datë 30 korrik 2024, me vendim të të njëjtit autoritet, z. T., është transferuar në pozicionin e Audituesit të Lartë pranë Departamentit të Auditimit të Performancës, me efekt nga data 1 gusht 2024. Ky ndryshim përfshinte edhe uljen e kategorisë dhe klasës së pagës.

Nga data 1 gusht deri më 31 dhjetor 2024, z. T., nuk është angazhuar në asnjë proces auditimi të plotë dhe nuk është ngarkuar me detyra specifike. Ai ka marrë pjesë vetëm pjesërisht në dy programe auditimi, përkatësisht një në muajin gusht (në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura) dhe një tjetër në dhjetor 2024, por asnjëri prej tyre nuk është përmbyllur nga ana e tij.

Më datë 5 qershor 2025, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka nxjerrë urdhrin për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me z. T., duke i dhënë fund një periudhe 12-vjeçare shërbimi të tij në administratën publike pranë këtij institucioni kushtetues.

Subjekti ankues pretendon se, gjatë periudhës 2024–2025, është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese në raport me kolegët e tij, duke iu ndryshuar pozicioni dhe kategoria e punës në mënyrë arbitrare, pa ndjekur procedurat ligjore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe në aktet nënligjore në fuqi. Sipas tij, këto ndryshime janë bërë pa një justifikim objektiv, duke cenuar stabilitetin e marrëdhënies së punës dhe duke e vendosur në kushte të pafavorshme profesionale dhe institucionale.

Gjithashtu, ai pretendon se është lënë pa angazhim në detyra konkrete audituese për një periudhë të gjatë prej rreth 6 muajsh, duke mos u përfshirë në auditime të rëndësishme, ndonëse kolegë të tjerë me vlerësim të ngjashëm kanë qenë të angazhuar rregullisht. Ky mospërfshirje, sipas ankuesit, ka ndikuar negativisht në performancën e tij të vlerësuar dhe në mundësitë për avancim në karrierë, duke e vendosur në një pozitë të pabarabartë me punonjës të tjerë të të njëjtit nivel.

Një tjetër aspekt i pretendimeve të z. T., lidhet me faktin se, pavarësisht mungesës së dokumentacionit zyrtar për ndonjë masë disiplinore apo vërejtje gjatë ushtrimit të detyrës, ai

është vlerësuar në mënyrë të padrejtë me notën më të ulët (4 – "jo kënaqshëm") për dy periudha të njëpasnjëshme vlerësimi, ndërkohë që më herët ka pasur vlerësime pozitive. Vlerësimet negative, sipas tij, nuk janë të argumentuara dhe nuk mbështeten në fakte apo dokumentacion të rregullt, përkundrazi bien ndesh me ecurinë dhe kontributin e tij profesional ndër vite.

Në përmbledhje, z. T., konsideron se veprimet e ndërmarra nga z. Sh., në cilësinë e Kryetarit të KLSH-së, kanë qenë të njëanshme, në shkelje të parimeve të trajtimit të barabartë dhe të meritës, si dhe kanë pasur efekt diskriminues për shkak të raportit personal të ftohtë me titullarin e institucionit. Ai argumenton se këto veprime kanë çuar në një degradim profesional të paarsyetuar dhe në përfundim, në largimin e tij nga shërbimi civil pas 12 vitesh përvojë të pandërprerë dhe pa rekorde disiplinore.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, përcaktohet se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër"*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *"Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi"*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në "shkakun e mbrojtur". Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe të mbrojtura, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat

mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë, të padrejtë e të pafavorshëm të tij nga ana e Kryetarit të KLSH-së, vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë i provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur nga LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Komisioneri vlerëson se, personi i cili pretendon se është diskriminuar për këto shkaqe, por jo vetëm, duhet gjithashtu të parashtrojë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë një apo më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, është “çdo shkak tjetër”.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁴.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të

³ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁴ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se:

“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”⁵

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë.

⁵ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Komisioneri vlerëson se, diskriminimi⁶ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Pala ankuese nuk provon me fakte e prova se mbart shkaqet e pretenduara, sipas përcaktimeve të LMD-së. Në kuptim të LMD-së, *“Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.”*⁷.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Kjo pasi, ankuesi nuk ka arritur të provojë apo dokumentojë se çfarë konsideron me “çdo shkak tjetër”, pra se cila është karakteristika e tij individuale, bazuar mbi të cilën Kryetari i KLSH-së, e ka trajtuar në mënyrë të diferencuar.

Në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim, pamundësohet vijimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

⁶ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përrjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

⁷ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

Pala ankuese nuk parashtrroi e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucionit përgjegjës që të jenë motivuar nga shkak i pretenduar, pasi *vetë shkak* nuk është i provuar prej tij.

Vetëm pasi ankuesi të provonte para KMD-së se mbart e posedon shkakun e pretenduar, atëherë Komisioneri mund të vihej në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e institucionit përkatës.

Po ashtu, Komisioneri konstaton se ankuesi ka identifikuar si shkak të diskriminimit të pretenduar *“çdo shkak tjetër”*, konkretisht *“për shkak të raportit personal të ftohtë me titullarin e institucionit”*, por ky pretendim nuk është shoqëruar me ndonjë sqarim të qartë lidhur me natyrën apo përmbajtjen e këtyre marrëdhënieve, as me ndonjë provë konkrete, fakt apo rrethanë që të vërtetojë ekzistencën e një sjelljeje të tillë nga ana e punëdhënësit. Në mungesë të një shkak të qartë, të identifikueshëm dhe të provuar sipas kërkesave të ligjit, pretendimi i ngritur mbetet në kuadër të supozimeve subjektive të palës ankuese dhe, për pasojë, nuk përmbush kriteret për t’u shqyrtuar si çështje diskriminimi në kuptim të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim⁸”*, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

Komisioneri evidenton faktin se, ankuesi, të gjitha pretendimet që burojnë nga veprimet apo sjellja e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, lidhur me ndryshimet e përsëritura në pozicionin e punës, uljen e kategorisë dhe klasës së pagës, mosangazhimin në auditime për periudha të zgjatura, si dhe vlerësimet negative të paarsyetuara apo ndërprerja e marrëdhënieve të punës, janë pretendime që lidhen me paligjshmërinë e prezumuar nga punëdhënësi, Kryetari i KLSH-së, kundrejt tij. Në mungesë të lidhjes me një shkak objektiv apo të ligjshëm që të justifikojë këto veprime, ato mbeten thjesht në kuadër të paligjshmërisë së tyre.

PËR KËTO ARSYE:

⁸ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, të KMD-së, Vendimi nr. 27, datë 23.01.2024, etj.

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç/ të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr. 169 Regj., datë 28.07.2025, të subjektit ankues z. A. T., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA